# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-471049**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjenerali Eric Wendt mbërrin në Pallatin e Brigadave, dorëzon letrat kredenciale te Presidenti Begaj dhe merr detyrën si Ambasador i SHBA në Shqipëri |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/aktualitet/gjenerali-eric-wendt-mberrin-ne-pallatin-e-brigadave-dorezon-letrat-k-i402073` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 09:57:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 09:53:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | a32a1837674cd905fb26e0244e148e50cfa9ff4ce9a0e91e0df532d679071190 |
| TEKSTI | e19ec66ba0f18d66b041c4193bc15f83f5383658799beae5896b8296f81b17fd |
| PAMJA | c146c9c2e915ff3a64852439be696555c5c196e570c9acf0799f72d3653b73f8 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 27c782988bed300a24565e13d06e2c7736675100dd3deee4ef98fc90f9a6de47 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | bbc3301522765d1bd7c753c64180377d11d281903b5d3d3b2cb5e4d7203a8042 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/27c782988bed300a24565e13d06e2c7736675100dd3deee4ef98fc90f9a6de47`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Aktualitet

26 Shtator 2026, 11:53

# Gjenerali Eric Wendt mbërrin në Pallatin e Brigadave, dorëzon letrat kredenciale te Presidenti Begaj dhe merr detyrën si Ambasador i SHBA në Shqipëri

Shkruar nga Newsbomb



Gjenerali Eric Wendt mberrin ne Pallatin e Brigadave, ne Tirane

Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Gjenerali Eric Wendt ka shkelur këtë të premte në tokën shqiptare dhe sot, më 26 Shtator, ka mbërritur në Pallatin e Brigadave ku pritet të dorëzojë letrat kredenciale te Presidenti Bajram Begaj.

Të hënën, ambasadori i ri amerikan pritet të vijojë axhendën e tij me një vizitë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku do të zhvillojë takimin e parë me ministrin Ferit Hoxha.

Ndërkohë, më 2 tetor, Ambasada Amerikane në Tiranë pritet të organizojë edhe ceremoninë e prezantimit të ambasadorit të ri, e cila do të mbahet në një hotel në qendër të kryeqytetit.

Ish-gjenerali amerikan vjen në Tiranë me një axhendë të përcaktuar dhe me disa prioritete të bëra publike prej tij gjatë dëgjesës në Senatin Amerikan. Në atë seancë, Wendt renditi katër drejtimet kryesore ku do të përqendrohet gjatë mandatit të tij në

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit


Foto e Ditës
Skënderbeu - Biri i Zotit


Sporti
Nis kapitulli i ri evropian për Shqipërinë e Maran, kuqezinjtë zbresin sonte në fushë përballë Bjellorusisë

Zbulo më shumë artikuj

Wendt rendit katër drejtimet kryesore ku do të përqendrohet gjatë mandatit të tij në Shqipëri.

Në fokusin e parë është mbrojtja e qytetarëve amerikanë dhe avancimi i interesave të Shteteve të Bashkuara, ku përfshihet edhe mbështetja për Shqipërinë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ndërkombëtar.



**Gjenerali Eric Wendt**

Një tjetër çështje e rëndësishme lidhet me sigurinë dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të NATO-s. Wendt ka deklaruar se do të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për rritjen e shpenzimeve në fushën e mbrojtjes, me objektivin e arritjes së nivelit 5% të PBB-së deri në vitin 2035.

Në axhendën e tij është edhe diplomacia ekonomike dhe tregtare. Ambasadori i ri amerikan ka nënvizuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ekonomike dhe krijimit të më shumë mundësive për bizneset dhe investimet amerikane në Shqipëri.

Ndërsa prioriteti i katërt lidhet me vetë stafin e Ambasadës Amerikane. Wendt e ka cilësuar këtë si "faktori njerëzor", duke theksuar nevojën për përdorimin e mënyrave standarde dhe kreative në funksion të punës së përfaqësisë diplomatike.

**Kush është Eric Wendt?**

Me mbi 34 vite shërbim aktiv, Wendt ka mbajtur një sërë pozicionesh të larta drejtuese, duke menaxhuar organizata komplekse me mijëra personel ushtarak, civil dhe ndërinstitucional. Përveç karrierës ushtarake, ai ka kontribuar edhe në diplomaci, duke shërbyer për dy vite në Departamentin Amerikan të Shtetit si pjesë e Ambasadës së SHBA-ve në Jerusalem. Në këtë rol, ai drejtoi një koalicion me tetë vende si Koordinator i Sigurisë për Izraelin dhe Autoritetin Palestinez, duke raportuar drejtpërdrejt te Sekretari i Shtetit.

Departamenti i Shtetit thekson se përvoja e tij e gjerë në lidership, aftësia për të menaxhuar struktura shumëkombëshe dhe ndërinstitucionale, si dhe njohja e thellë e rajonit evropian e bëjnë Wendt një kandidat shumë të kualifikuar për të përfaqësuar Shtetet e Bashkuara në Shqipëri.

Në aspektin akademik, Wendt ka përfunduar studimet Bachelor në Universitetin e Kalifornisë, Santa Barbara, si dhe një diplomë Master në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në Monterey, Kaliforni. Ai zotëron gjithashtu njohuri në gjuhën arabe dhe koreane.

Për kontributin e tij ndër vite, ai është vlerësuar me një sërë dekoratash dhe çmimesh prestigjioze, përfshirë Medaljen e Shërbimit të Shquar të Mbrojtjes, Medaljen e Shërbimit të Shquar, Medaljen e Yllit të Bronzit dhe Çmimin e Nderit të Lartë të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve.

## Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Lexo gjithashtu

Aktualitet



E Shtunë 11:51

## Aksidenti tragjik në Fushë-Krujë, në zi edhe Forcat e Armatosura! I riu që humbi jetën ishte pjesë e Akademisë




Aktualitet

Pse Vlora Hyseni zbriti në Kosovë para Shqipërisë? Gazetari zbulon të vërtetën e itinerarit të ish-drejtoreshës së SHISH: Ishte në spital!

E Shtunë 11:40



Aktualitet

Çfarë e lidh Bledar Cafin me Indrit Doklen?! Dy "shënjestrat" e SPAK të akuzuar për trafik droge dhe organizatë kriminale

E Shtunë 11:23

Aktualitet



E Shtunë 10:57

## Prokurori Adnan Xholi firmos urdhërarrestet, RENEA mësyn në bazat e Shkodrës dhe në shtëpitë e Indrit Dokles! VIDEO: Cafi i kryeqendrës së veriut me siguri maksimale, muret disa metra të lartë







Aktualitet

VIDEO/ Ndjekje si në filma në Durrës: 30 vjeçari manovra të rrezikshme në rrugë me makinën që vodhi në Tepelenë, tenton t'i shpëtojë Policisë dhe shkakton aksident masiv

E Shtunë 10:33



Aktualitet

I kërkuar për trafik droge, 53 vjeçari ukrainas prangoset sapo zbret në Rinas (FOTO)

E Shtunë 10:08



Aktualitet

E Shtunë 09:47

## Ksamili kërkon "divorcin" nga Saranda, banorët nisin mbledhjen e firmave për referendum: Duam të jemi bashki më vete



Aktualitet

Plan masash për garantimin e rendit dhe sigurisë, Policia e Shtetit njofton rrugët që bllokohen prej orës 17:00 në Tiranë për ndeshjen me Bjellorusinë

E Shtunë 09:24



Aktualitet

Breshëri plumbash ndaj lokalit të shqiptarit në Athinë, plagoset vajza 10 vjeçare, Policia gjen një makinë të djegur (PAMJET)

E Shtunë 07:46



Aktualitet




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.